RAPORT I PUNËS
(Korrik - Shtator 2025)

Prishtinë, Korrik 2025

Përmbajtja

Lista e shkurtesave....3
Për Ne....4
Vizioni....5
Misioni....5
Departamenti i financave....6
Departamenti ligjor dhe administrata....9
Departamenti i shitjes dhe marketingut....10
Departamenti i shërbimeve të përbashkëta....12
Zyra për menaxhimin e kontratave....13
2. Raporti i Përshtatshmërisë....16

Lista e shkurtesave

NPL – Ndërmarrje publike lokale
KQ- Kuzhina Qendrore
KK – Kuvendi Komunal
KP- Komuna e Prishtinës
KA – Komisioni i Aksionarëve
KB - Kryesuesi i Bordit
DB – Drejtorët e Bordit
KAB – Komisioni i Auditimit të Brendshëm
KE – Kryeshefi Ekzekutiv
IP - Institucionet Parashkollore.
BZ - Brigada e Zjarrfikësve
SHF- Shkolla Fillore

Për Ne

Ndërmarrja Publike Lokal "Ku'zina" sh.a., është themeluar bazuar në Ligjin nr. 03/L-87 për ndërmarrjet publike. Është themeluar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, ku Komuna e Prishtinës është aksionar i 100%. Ndërmarrja fushë veprimtarinë e vet e bazon ne Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si dhe në aktet e brendshme të nxjerra nga Aksionarët dhe Bordi.

Organizimi:

Ndërmarrja publike lokale Ku'zina, është shoqëri aksionare e themeluar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Aksionar i 100 për qind i saj është Kuvendi komunale i kryeqytetit, i cili përfaqësohet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve. Komisioni Komunal i Aksionarëve përbehet nga tre anëtar. Dy anëtar me vota të barabarta zgjedhën nga Kuvendi Komunal i kryeqytetit dhe një anëtar zgjidhet, po ashtu me votë të barabartë zgjidhet nga kryetari i kryeqytetit.

Në aspektin organizative të udhëheqjes, përveç Komisionit Komunal të Aksionareve, ndërmarrja ka edhe Bordit e Drejtorëve. Bordi i drejtorëve përbehet nga 5 anëtar. 4 anëtar, përmes proces të hapur rekrutues zgjedhën nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

Struktura Organizative

Punët nga veprimtaria e vet Ku'zina i organizon sipas nevojave dhe kërkesave që i kërkon procesi i punës, në varësi të llojit dhe vëllimit të punëve të ngjashme dhe të ndërlidhura në mes veti.

Duke u nisur nga lloji i biznesit, Ku'zina ka themeluar njësit organizative dhe përcaktuar fushëveprimin e punës se tyre:

- Kryeshefi Ekzekutiv
- Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit
- Zyrtari i Auditimit të Brendshëm
- Këshilltari i Përgjithshëm - Sekretari
- Departamenti Ligjor dhe i Administratës
- Departamenti i Financave
- Departamenti i Prodhimit dhe Furnizimit

- Departamenti për Shitje dhe Marketing
- Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta
- Departamenti Ligjor dhe i Administratës i kryen punët juridike dhe administrative me interes të Ndërmarrjes;
- Departamenti i Financave i kryen punët financiare - llogaritare dhe kontabilitetit me interes të Ndërmarrjes; - aktivitete tregtare;
- Departamenti i Prodhimit dhe Furnizimit, mbikëqyrë dhe koordinon aktivitetet e kuzhiniereve apo punëtorëve të tjerë të kyçur në përgatitjen e ushqimit; mbikëqyrë përgatitjen e ushqimit në Kuzhinë duke i respektuar në përpikëri dozimin e përbërësve ushqimor.
- Departamenti për Shitje dhe Marketing- Mbikëqyrë dhe koordinon procesin e shitjes dhe marketingut.

Punët sistemohen sipas llojit, kompleksitetit dhe kushteve të tjera të nevojshme për kryerjen e tyre brenda pjesëve organizative.

Vizioni

Të jemi ofruesi kryesor i shërbimeve kateringu me cilësi të lartë, i njohur për ekselencë në ushqyerjen, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit, duke u zgjeruar përtej institucioneve publike në klientët e sektorit privat. Synojmë të krijojmë një përvojë ushqimore të lehtë me fokus në inovacion, opsione të shëndetshme dhe shërbim të shkëlqyer ndaj klientit. Prandaj vizioni i kompanisë është:

Misioni

Të ofrojmë ushqime të freskëta, të shëndetshme dhe të balancuara për shkolla, kopshte dhe organizata të sektorit privat, duke siguruar vlerë të lartë ushqyese ndërkohë që ruajmë përballueshmërinë dhe efikasitetin. Misioni ynë zgjerohet për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve dhe nxënësve duke ofruar opsione ushqimore cilësore dhe të qëndrueshme.

Vlerat kyçe

Cilësia: Të ofrojmë ushqime të standardit të lartë duke përdorur përbërës të freskët dhe cilësore.

Qëndrueshmëria: Të përdorim burime lokale, produkte organike dhe opsione të paketimit ekologjik.

- Inovacioni: Të zbatojmë teknologji moderne në përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.
- Efikasiteti: Të optimizojmë operacionet për një shpërndarje dhe menaxhim me kosto efektive.
- Përputhshmëria: Të ndjekim të gjitha rregullat dhe standardet e sigurisë ushqimore.

Departamenti i financave

Departamenti i financave në periudhën raportuese ka luajtur një rol të shumëfishtë në përfshin menaxhimin e aseteve financiare të ndërmarrjes, planifikimin financiar, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Roli i këtij departamenti mund të përmblidhet në funksionet e mëposhtme kryesore siç është planifikimi financiar dhe buxhetimi, kontabiliteti dhe raportimi financiar si dhe kontrolli i kostove dhe efikasiteti operativ. Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjes se ndërmarrjes.

Të ardhurat dhe fitimet

Periudha e fundit e vitit 2025 ka arritur vlerën e shitjes 814,716.12 euro. Rritja e të hyrave ka ndodhur më së shumti në muajin Nentor të këtij viti si rezultat i rritjes së numrit të vijueshmërisë së fëmijëve pranë Institucioneve Parashkollore Publike dhe Publiko-private dhe përfundimin e pushimeve verore të Institucioneve Parashkollore.

Në këtë periudhe të vitit të kaluar (2024), të hyrat kanë qenë 675,632.55 euro.

Në TM4 të vitit 2025 kemi 139,083.57 euro më shumë të hyra krahasuar me vitin 2024. Kurse te hyrat nga operatorët privat janë rritur për 4,889.62 euro krahasuar me vitin paraprak. Totali i këtyre të hyrave është 21,287.36 euro.

Shitje TM4	IP, QS, SHP,BZ	Op.Privat	Totali
Tetor	270,104.63	7,210.81	280,315.44
Nentor	273,120.75	7,263.85	280,384.60
Dhjetor	274,203.38	6,812.70	254,016.08
Total		21,287.36	**814,716.12**

Në tre mujorin e fundit të vitit 2024, ndërmarrja ka ndarë buxhet prej 270,791.91 euro për paga. Kurse këtë vit totali i buxhetit të pagave është 287,727.13 euro.

Krahasuar me vitin e kaluar(2024) për periudhën e njëjte kemi shtim të buxhetit prej 16,935.22 euro. Bazuar në performancen e mirë financiare të ndermarrjes, të gjithë punëtoret kanë gëzuar edhe pagën e trembëdhjete.

Viti 2025	Paga Bruto
Muaji Tetor	70,894.11
Muaji Nentor	71,342.08
Muaji Dhjetor	145,468.01
Totali për tre muaj	287,727.13

Shpenzimet

Në tabelën me poshtë janë paraqitur llojet e shpenzimeve të ndodhura gjatë këtij tre mujori të fundit të vitit 2025

Në vitin 2024 vlera totale e shpenzimeve për këtë periudhe ka qenë 290,596.99 euro. Këtë vit kemi 90,368.27 me shume sepse kemi pasur shpenzime dhe investime si në rastin e veshjeve me frigo të veturave për bartje të ushqimit. Gjithashtu në këtë periudhë është faturuar edhe një pjesë e blerjes së aseteve në vlerë 178,559.32 euro. Nga kjo tabelë vërejme gjithashtu se shpenzimet që kane pësuar me së shumti rritje janë ato të energjisë elektrike rreth 92%, krahasuar me vitin e shkuar. Gjithashtu pjesmarrje të madhe kanë shpenzimet

për brendim, që ne ketë fazë perfshinë furnizimin me uniforma dhe përgaditjen e disa materialeve promovuese dhe shenjëzimin sidomos në objektin e ri të ndermarrjes. Shohim që edhe qiraja ka filluar faturimin nga muaji Nëntor 2025 , qe tashmë është një shpenzim fiks shoqeruar edhe me qiranë e veturave.

Qëllimi i ndermarrjes është gjithmonë ngritja dhe avancimi i personelit administrativ dhe operativ, andaj edhe shpenzimet për trajnime gjithëmone marrin pjesmarrje të medha në raportet tremujorshe.

Tabela e shpenzimeve

	Tetor	**Nëntor**	**Dhjetor**	**Totali**
Totali i shpenzimeve	**96,022.95**	**121,077.44**	**163,864.87**	**380,965.26**
Lënda e parë	79,338.42	56,798.56	65,170.54	**201,307.52**
Shpenzime për naftë	957.54	1,076.25	866.81	**2,900.60**
Shpenzime për telefon	57.31	34.77	107.62	**199.70**
Shpenzime për trajnime-avancim		19,800	1,626	**21,426.00**
Shpenzime të reprezentacionit	172,49	29.40	119.80	**321.69**
Shpenzime tjera (ushqimit)			1,021.78	**1,021.78**
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	**152,55**
Shpenzime të rrymës	3,242.62	3,567.64	3,233.19	**10,043.45**
Shpenzime për material shpenzues		5.75	116.56	**122.31**
Shpenzimet për zyre	14.40	118.22		**132.62**
Shpenzimet e higjienës	75.42	934.19	533.45	**1,543.06**
Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave, sigurimi dhe servisim	32.42	1,552.55	918.53	**2,503.50**
Shpenzimet e transportit	821.10	535.50	785.40	**2,142.00**
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit[i]	360	4,838.80	700	**5,443.80**

Shpenzimet e paketimeve	1,631.36		1,737.29	**3,368.55**
Shndërrimi i veturave në frigo		8,177.97	32,711.87	**40,889.84**
Shpenzimet e GPS-ve së veturave			101.69	**101.69**
Shpenzimet e qirasë së veturave	6,766.10	6,766.10	6,766.10	**20,298.30**
IKSHPK	204		375	**579**
Shpenzimet e sigurimit shëndetësor	2,042.50	2,042.50	2,067.30	**6,152.30**
Shpenzimet për brendim dhe promovim			20,350.00	**20,350.00**
Shpenzimet e mirëmbajtës			1,301.70	**1,301.70**
Shpenzime për material-mjete pune	256.42			**256.42**
Shpenzimet e qirasë se Objektit		15,203.39	15,203.39	**30,406.78**
Shpenzimet për udhëtim dhe akomodim të stafit jashtë vendit[ii]			8,000	**8,000**

Blerje e Aseteve

Asete për Kuzhine, situacioni i parë			178,559.32

Departamenti ligjor dhe administrata

Ky raport përmbledh aktivitetet dhe rezultatet e arritura nga Departamenti Ligjor dhe Administrata i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A., gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025. Gjatë kësaj periudhe, departamenti ka vepruar në përputhje me kërkesat organizative dhe detyrimet ligjore, duke kontribuar në konsolidimin e kornizës rregullative dhe mbështetjen administrative të ndërmarrjes.

Fokus i veçantë i punës ka qenë sigurimi i funksionimit efikas të strukturave vendimmarrëse, menaxhimi korrekt i dokumentacionit ligjor, si dhe përmirësimi i kushteve të punës dhe shërbimeve për stafin. Fokusi në këtë tre mujor ka qenë të përgatitja e transferimit nga objekti i vjeter tek objekti i ri, ku është punuar në hartimin dhe draftimin e

kontratës si dhe jemi kujdes që cdo gjë që parashihet më norma ligjore dhe që është në interes të zhvillimit të ndermarrjes të jetë e përfshirë brenda kornizes kontraktuale me operatorin privat.

Departamenti Ligjor dhe Administrata mbetet i përkushtuar në përmbushjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes dhe në garantimin e funksionimit të ligjshëm e efikas të saj. Me një qasje të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm, departamenti do të vazhdojë të ofrojë mbështetje profesionale në të gjitha proceset që lidhen me administrimin dhe menaxhimin juridik të ndërmarrjes.

Departamenti i shitjes dhe marketingut

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në Institucionet Parashkollore (IP), Qendrat Sociale, BPZ Zjarrfikësit, Qendrën Sociale për të moshuar dhe Shkollat Fillore.

Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës.


Më poshtë, mund të gjeni edhe tabelat e shpërndarjes së shujtave për tre mujorin e katërt të vitit 2025.

	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Institucionet Parashkollore Publike	37,540	31,306	32,561
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	19,665	16,185	17,665
Qendrat Sociale	6,900	5,700	6,300
Qendra Sociale për të moshuar	6,105	5,520	6,069
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	2,138	2,051	1,919
Shkollat Fillore	85,144	97,461	78,552


Shërbimet Catering	5 organizime 272 persona	1 organizim 50 persona	4 organizime 75 persona
Porosit private	6 biznese, 2,751 porosi	5 biznese, 2,544 porosi	5 biznese, 2,348 porosi

Në tremujorin e katërt të vitit 2025, më saktësisht nga fillimi i muajit Tetor, Ku`zina ka filluar shpërndarjen e shujtave ushqimore edhe në një shkollë fillore, më saktësisht në Shkollën Fillore "Zenel Hajdini".

Po ashtu, ndërmarrja ka vazhduar edhe shpërndarjen e shujtave ushqimore për Institucionet Parashkollore Publike dhe ato me bazë në komunitet, Qendrat Sociale Aktash dhe Tophane, Qendrat Sociale për të moshuar dhe BPZ Zjarrfikësit.



Krahasuar me të njëjtën periudhë (TM4) të vitit të kaluar, ndërmarrja ka shënuar rritje të shitjeve private në baza ditore, ndërsa është evidentuar një rënie e ndjeshme në shërbimet e cateringut. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar gjithsej 10 kokteje rasti për 397 persona.



Departamenti i shërbimeve të përbashkëta

Departamenti i shërbimeve të përbashkëta në tre mujorin e katërt të vitit 2025 ka pasur këto angazhime:

Në bazë të rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes si dhe në bazë të kontratës "Në Shtëpi" që ndërmarrja jonë N.P.L "Ku'zina" sh.a ka me Komunën e Prishtinës, gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Shërbimeve të përbashkëta në bashkëpunim edhe me Departamentin e Financave ka përcjelle procesin e dërgimit të shujtave në Institucionet Parashkollore, gjithashtu kemi kryer regjistrimin e shujtave si dhe dërgimin e faturës së rregullt mujore në Komunën e Prishtinës.

Në kontekst të këtij obligimi, duhet të theksojmë që edhe në tre mujorin e katert, për shkaqe të problemeve financiare të Komunës së Prishtinës, ne kemi vazhduar të kemi vonesa në pagesat e faturave nga ana e DKA-së, e ku vlen të theksohet se gjendja fatkeqësisht nuk ka shkuar drejtë përmirësimit.

Përkundër kësaj, është shumë e rëndësishme të theksohet se ne si ndërmarrje në asnjë moment nuk kemi rrezikuar shërbimet tona për shërbimin e shujtave, si për institucionet parashkollore, shkollat me mësim tërë ditor, rastet sociale apo për qendrën e zjarrfikëseve.

Brenda këtij shtjellimi të menaxhimit të kontratës më Komunën, dua të ritheksoj, se kontrata me Komunën e Prishtinës, ka skaduar, me datë 11.11.2025, dhe deri në përgatitjen e këtij raporti nuk është nënshkruar.

Në tre muajt e katërt të këtij viti kemi vazhduar bashkë me zyrtarin e autoparkut të kujdesemi për mjetet e transportit të ushqimit, ku gjatë kësaj kemi servisuar disa nga automjetet tona, por çka vlen të theksohet është, se në këtë periudhë kemi dërguar veturat tona për izolimet

e brendshme frigo, që mundëson që ushqimi i jonë gjatë shpërndarjes së tij të ruaj temperaturën e duhur, deri në dërgimin e tij tek institucionet përkatëse.

Sa i takon oborrit dhe higjienës vazhdojmë te kemi një ndarje javore të stafit, të cilët në baza ditore kujdesen për hapësirat e jashtme. Vlen të theksohet se ne si ndërmarrje kemi një bashkëpunim institucional me N.P.L "Gjelbërt" sh.a. apo siç njihet si Hortikultura, por të njëjtit kohet e fundit, nuk kanë pasur mundësi financiare që t'i kryejnë obligimet e rregullta, për çka kanë kërkuar mirëkuptimin tonë.

Krejt ne fund të këtij raporti, duhet të vlerësojmë pozitivisht sektorin e sigurimit të objektit, të cilët përkundër vështirësive financiare nga kompania e tyre "Skifterat" kanë vazhduar të jenë efektiv dhe në krye të detyrës së tyre, e në raste jo të rralla edhe të na ndihmojnë në punët tona të ndërmarrjes.

Zyra për menaxhimin e kontratave

Ky raport ka për qëllim të përmbledh aktivitetet dhe përgjegjësitë që janë realizuar gjatë periudhës tre mujorit TE KATERT të vitit 2025 në lidhje me menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës për të siguruar që kontratat kanë qenë efektive dhe kanë sjellë rezultate të dëshiruara për palët sipas kritereve te përcaktuara ne kontratat aktive .

Aktivitetet kanë përfshirë shqyrtimin e kontratave, monitorimin e zbatimit të tyre, si dhe evidentimin dhe mbikëqyrjen e proceseve të ndryshme lidhur me kontratat aktive si:

- Shqyrtimi i kontratave.
- Monitorimi i zbatimit të kontratave.
- Raportimi dhe analiza e kontratave.
- Specifikimet e faturave apo flet-dërgesave.
- Konstatimi për pagesa për 18 kontrata aktive.
- Evidenca në specifikacione sipas flet-dërgesave dhe faturave që janë pranuar nga menaxherët e caktuar..
-

1. **Raporti i Analizës Financiare**

Ky raport shqyrton efektivitetin financiar të kontratës dhe koston totale të furnizimit per periudhën TM4 2025 te kontratave aktive dhe kontratave te reja :

Nr	FURNIZIME - Emertimi kontratave me AQP-n (2025-2026)	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
1	Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit- Loti 1	€ 8,896.50	€ 8,360.20	€ 8,620.50	€ 25,877.20
2	Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës. Loti 2	€ 4,433.33	€ 4,355.93	€ 3,019.42	€ 11,808.68
3	Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit -Loti 3	€ 4,225.41	€ 4,357.88	€ 4,467.80	€ 13,051.09
4	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 4	€ 3,836.75	€ 2,799.80	€ 3,207.37	€ 9,843.92
5	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 5	€ 6,730.02	€ 5,567.91	€ 4,952.20	€ 17,250.13
6	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjerë	€ 28,224.65	€ 20,994.30	€ 18,638.33	€ 67,857.28
7	Furnizim me karburant ne rajonin e Prishtines	€ 1,129.90	€ 1,270.00	€ 945.82	€ 3,345.72
8	Furnizimi me uje te pijes	€ 300.96	300.96	€ 300.96	€ 902.88
	FURNIZIME - Emertimi kontratave per KQ-n (2025- 2026)				
9	Furnizim me artikuj te ndryshem ushqimor - Drithera	€ 1,248.40	€ 2,109.64	€ 0.00	€ 3,358.04
10	Furnizim me material Higjientik	€ 89.00	€ 1,102.35	€ 627.92	€ 1,819.27
11	Furnizim me paketime ushqimore	€ 1,925.00	€ 1,170.00	€ 2,050.00	€ 5,145.00
12	Furnizimi me Vetura PICk -UP (36 muaj)	€ 7,984.00	€ 7,984.00	€ 7,984.00	€ 23,952.00
13	Furnizim me Peme dhe Perime (6 Muaj)	€ 30,132.80	€ 13,539.20	€ 26,370.38	€ 70,042.38
14				€ 210,700.00	€ 210,700.00
	Sherbime - Emertimi kontratave per KQ-n (2025 - 2026)				
15	Mirembajtja dhe sevisimi I Automjeteve	€ 0.00	€ 1,832.00	€ 0.00	€ 1,832.00
16	Sigurimi shendetsor dhe aksidental per punëtoret e Kuzhines Qendrore	€ 1,934.40	€ 1,934.40	€ 1,959.20	€ 5,828.00
17	Shendrrimi I veturave Pick- Up nga situata standarde ne sisitem me frigo - Loti 1 dhe Loti 2	€ 9,650.00	€ 38,600.00	€ 9,650.00	€ 57,900.00
18	Krijimi I identitetit (Brendimi)dhe prezantimi medial per npl Ku'zina .		€ 24,013.00	€ 50,261.80	€ 74,274.80
	Sherbime - Emertimi I kontratatave ne mes institucioneve publike dhe ndermarrjeve publike lokale KQ				
19	Biltetat e veqanta per staf (te hershum) (nuk ka vlere te caktuar)	€ 821.10	€ 535.50	€ 785.40	€ 2,142.00
20	Kontrata me IKSHPK-n	€ 204.00		€ 375.00	€ 579.00
	Total vlera financiare:				**€ 607,509.39**


Gjate kësaj periudhe ndërmarrja ka zhvilluar aktivitete te furnizimit dhe shërbimit me gjithsej 20 operator, te cilët i kemi nda ne 4 kategori me përshkrim sipas tabelës se me sipërme:

1 Kontrata aktive te furnizimit me Agjencinë qendrore te prokurimit

2. Kontrata aktive te furnizimit me Zyrën e Prokurimit te ndërmarrjes

3.Kontrata aktive shërbyese

4. Kontrata shërbyese – marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike dhe lokale.



2. Raporti i Përshtatshmërisë

Ky raport përqendrohet në përgjithësi dhe ne përputhshmërinë e furnizueseve te kontratave aktive te ndërmarrjes me kushtet e kontratës dhe rregullores per menaxhim te kontratave aktive.

Kriteri	Përshtatshmëria (Po/Jo)	Komente dhe Shpjegime
Respektimi i afateve të dorëzimit	Po	Dërgesat janë bërë në kohë, me vonesa mesatare
Përputhshmëria me standardet e sigurisë ushqimore	Po	Produktet janë të certifikuara dhe të siguruara.
Furnizimi i produkteve me cilësi të kërkuar	Po	Disa produkte kishin mungesa në cilësi dhe janë kthye për përmirësim.
Çmimet dhe shpenzimet	Po	Çmimet ishin në përputhje me ato të negociuara.
Respektimi i kushteve etike	Po	Furnizuesi ka ndjekur praktikat e duhura etike.

3. Te ndryshme

3.1 Gjate kësaj periudhe janë nënshkruar 9 kontrata publike kornizë ne periudhe një vjeçare. Prej tyre 5 kontrata kane qene vazhdim për furnizim me AQP-n ,3 kontrata te furnizimit me KQ-n dhe një kontrate afatshkurtër shërbyese.

3.2 Bazuar ne kërkesën e zyrës se prokurimit në përgatitje të planit të prokurimit për vitin 2026 në bashkëpunim me njësit kërkuese dhe të gjitha departamentet e ndërmarrjes kemi bërë përshkrimin e kontratave aktive dhe kontratave të reja të cilat planifikohen të zbatohen për vitin 2026 .

Në plan janë të parashikuara të gjitha kategoritë dhe shërbimet investive në vlerë totale prej : 1,123.986.50.00 Euro.

3.3 Me kërkesë te AQP si dhe në njoftimin e aktiviteteve të prokurimit nga AQP-ja në bashkëpunim me njësit kërkuese, kemi bërë përgatitjen e listave të artikujve për Furnizim me artikuj ushqimor – Lot 3 dhe Lot 5 për periudhën 12 mujore. Lista e artikujve ushqimor është dorëzuar duke u bazuar në menytë e reja sipas njësive kërkuese që kanë bëre për shkolla dhe kopshte në proporcion me rritjen e numrit të sasive të planifikuara.

Zyra e burimeve njerëzore

Ky raport përmbledh aktiviteteve nga Departamenti Ligjor dhe Administrata përkatësisht Zyra e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A.
Zyra e Burimeve Njerëzore ka vijuar të jetë e nevojshme për punën e kapaciteteve profesionale të stafit si dhe nevojave të tjera operative të ndërmarrjeve. Me rritjen e vëllimit të punës dhe zgjerimin shërbimeve në shkollave, është rritur numri i stafit në sektorin e prodhimit. Tri serviruse dhe tre kuzhinier.
Gjatë kësaj periudhe, stafi ka marrë pjesë në trajnime me fokus në:

- Sigurinë ushqimore dhe higjienën
- Organizimi i punës në kuzhinë
- Përmirësimin e bashkëpunimit në ekip

Këto trajnimet kanë kontribuar në:

- Rritjen e efikasitetit në procesin e ushqimit të ushqimit
- Uljen e gabimeve operative
- Rritjen e ndërgjegjësimit për standardet e ushqimit
- Përmirësimin e performancës individuale dhe kolektive

Objektivat për tre muaj e ardhshëm

- Vazhdimi i trajnimeve profesionale
- Monitorimi i performancës së stafit të ri
- Përmirësimi i planit të burimeve njerëzore sipas nevojave operative

Zyra e Prokurimit

Gjatë tremujorit tetor – dhjetor 2025, zyra e prokurimit ka inicuar 7 procedura prokurimi që kryesisht kanë qenë furnizimi dhe shërbime. Qëllimi kryesor i këtyre procedurave ishte sigurimi i furnizimeve cilësore në mënyrë transparente, efikase dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha procedurat janë zhvilluar në përputhje me ligjin për prokurim publik dhe rregullat e brendshme të institucionit. Nuk janë evidentuar shkelje procedurale.

Më poshtë gjeni tabelën e plotë me të dhënat e procedurave të inicuara gjatë tremujorit tetor–dhjetor 2025.

Procedurat	Data e incimit	Vlera
Furnizimi me peme dhe perime	20.10.25	134.255.00
Transporti i zyrtareve te kuzhinës për vizite studimore	31.10.25	700.00
Furnizimi me inventar te zyreve dhe kuzhinës	02.12.25	25999.00

Furnizimi me drithëra për Institucionet parashkollore	03.12.25	28529.00
Pastrimi gjeneral i objektit t e kuzhinës ne Lakërishtë	11.12.25	979.80
DDD i objektit te kuzhinës qendrore ne Lakërishtë	21.12.25	988.00
Sigurimi i automjeteve te kuzhinës	23.12.25	705.29
Totali		57901.09

Fund!

[i] Udhëtimi me ekipin e Strategjisë në Vjenë.
[ii] Udhëtimi i stafit të Kuzhinës për fund vit në Shqipëri.